



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 2, datë 31.01.2023

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin janar, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 31.01.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Mbajmë sot mbledhjen e radhës për vitin 2023 për Këshillin Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë, nga anëtarë të këshillit bashkiak, do informohemi mbi raportin 12 mujor të punës së Këshillit për vitin 2022 si dhe raportin e punës së Drejtorisë Burimeve Njerëzore të bashkisë sipas programit të këshillit. Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit . Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Kryetar ke 33 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hyn me vonesë në pikën 3 një këshilltare S. Kavaja, pra 34 këshilltarë. Gjatë mbledhjes ikin nga salla 2 këshilltarë (në pikën 2 largohet V. Mustaka dhe në pikën 8 largohet Sh. Ibrahim).

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi **13** pika.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO, QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN JANAR 2023
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË DHE NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.142, DATË 24.11.2022 NË LIDHJE ME VENDBAZIMET E MJETEVE LUNDRUESE
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.152, DATË 22.12.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023”
Pika 5. Informim Këshilltarëve	RAPORTIM NGA DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE TË BASHKISË, NË ZBATIM TË VKB-SË NR.139, DATE 24.11.2022
Pika 6. Informim Këshilltarëve	RAPORT PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2022
Pika 7 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të 5 anëtareve të Këshillit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VKB NR. 139, DATË 24.11.2022 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2023”
Pika 8 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.157, DATË 22.12.2022, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 23300242.8 (NJËZETËETREMILION E TREQINDMIJË E DYQIND E DYZETË E DY E TETË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESE E KËTUIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME

	OBJEKT: “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTOROMANOS - KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË
Pika 9 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 55, DATË 31.5.2022, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 21561573.6 (NJËZETË E NJË MILION E PESËQIND E GJASHTËDHJETË E NJË MIJË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E TRE LEKË E GJASHTË QINDARKA) LEKË, PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA” (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH), I NDRYSHUAR
Pika 10 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.1, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETË E TETË MILION E TREQIND E DYZETË E DYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHËTITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”
Pika 11 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE, QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL
Pika 12 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PRANË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2023
Pika 13 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI” RRUGA “RAMADAN VELIU” TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, DUKE PËRFSHIRË Z. HYSEN JONUZI

Atëherë përse i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës. Bashkia nëpërmjet relacionit sjell miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor. Komisioni dakortësoi miratimin e këtij projektvendimi dhe kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj. Meçi.

Klementina Meçi: Atëherë komisioni mori në shqyrtim dhe pikën 2 të rendit të ditës vendosi me vota unanime që ky projektvendim të kalojë në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 2 kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Fatmir Mërkuri.

Fatmir Mërkuri: Komisioni ynë pasi mori në shqyrtim pikën 3 të rendit të ditës votoi pro kalimit të saj në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

I japim fjalën Komisionit të Politikave të Zhvillimit të Turizmit z. Artion Beqiraj

Artion Beqiraj : Komisioni është dakort dhe vendosi ta kaloj atë.
Kam një detajim apo ta bëj më pas.

Ani Dyrmishi : Po, bëje.

Artion Beqiraj : Ky projektvendim ka të bëj me propozimin për një vendbazim të ri dhe një spostim. Në rastin konkret ky spostim do të thotë të ndahet të shkoj në një vend tjetër apo mund të bëhet një rikthim?

Emiriana Sako: Besoj se ka lidhje me distancat. Renis mund të japësh një sqarim për vendbazimet.

Renis Mullaj : Mund ta bësh dhe njëherë pyetjen të lutem?

Artion Beqiraj : Në këtë pikë që sillet si propozim është një pikë për shtimin e një vendbazimi të ri dhe një pikë për ndryshimin e vendbazimit nga njëri vend në tjetër. Në këtë rast pse lind e nevojshme ky spostim? Apo qëndron një shtesë e re. Qëndron aty ku ishte dhe të shtohet?

Renis Mullaj : Për shkak se vendbazimet nga njëri-tjetri duhet të kenë një largësi, që përcaktohet në VKM nr.171/2019, që është për kushtet dhe rregullores së stacioneve të plazhit. Ato kanë një largësi dhe në momentin që dalin në det të hapur, duhet të kenë një kriter largësie për shkak të problematikave që mund të lindin për shkaqe të ndryshme. U pa e arsyeshme që më mirë të bëhet një spostim se sa të krijohet një vendbazim në një largësi më të madhe. Ndërsa përsa i përket vendbazimit tjetër që është në zonën e Agipit në fillim të plazhit e gjithë zona aty nuk ka asnjë vendbazim për mjetet lundruese, koridor lëvizje. Dhe duke parë hartën që “Ne” e miratuam me mbledhjen e radhës që kaluat u pa dhe kjo e arsyeshme vendosja e një vendbazimi për shkak të kërkesave që ka pasur dhe duke plotësuar kriteret, subjektet mund të marrin lejet përkatëse.

Artion Beqiraj : Po, shumë mirë. Faleminderit.

Renis Mullaj : Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 3 kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj: Komisioni jonë u mblodh dhe ra dakort për pikën 4 dhe vendosi ta kaloj në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përse i përket pikës 4 kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Përse i përket **pikës 5** të rendit të ditës “*Informim i këshilltarëve*”, i jepet fjala për një raportim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të bashkisë, në zbatim të VKB-së nr.139, datë 24.11.2022, Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore zj. Dhurata Gjoka.

Dhurata Gjoka (Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore): Lexoi raportin dorëzuar pranë Sekretariatit të Këshillit me nr.prot 608/1, datë 26.01.2023.

Ani Dyrmishi : Keni ndonjë pyetje përse i përket raportit?

Pyetje nuk ka. Faleminderit zj.Gjoka.

- Përse i përket **pikës 6** të rendit të ditës besoj të gjithë e keni lexuar raportin. Për të mos u zgjatur po e shpreh në vija të përgjithshme, pasi më të detajur e keni në raport, i cili do të bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, kështu që do të jetë i aksesueshëm dhe për publikun :

Të nderuar këshilltarë !

Ky raport mbahet në përmbushje të detyrimit të parashikuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendim nr.25, datë 29.04.2020. Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi mbledhjet e këshillit, mbledhjet e komisioneve, vendimet e marra dhe konsultimet publike.

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli bashkiak.

Për periudhën janar – dhjetor 2022, janë marrë 157 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës.

Nga karakteri i vendimeve mund t’i ndajmë në:

1. për probleme financiare - 30 vendime,
2. për probleme sociale - 16 vendime,
3. për infrastrukturën dhe strehimin - 75 vendime,
4. për problemet urbane dhe asetet - 13 vendime,

- 5. për emergjencat civile - 4 vendime,
- 6. për probleme të arsimit kulturës - 6 vendime,
- 7. të ndryshme - 13 vendime.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht me familjet përfituese në kuadër të procesit të rindërtimit .

Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi plane e rregullore si më poshtë :

1. Planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota të bashkisë Durrës për vitin 2022 (VKN nr.27)
2. Rregullores së administrimit të mbetjeve në bashkinë Durrës (VKB nr.41).
3. Planin Social për Bashkinë 2023-2025 (VKB nr.151).

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet)

Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2022 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për 155 Vendime. Vetëm 2 vendime janë kthyer : VKB nr.58, datë 31.05.2022 dhe VKB nr.93, date 06.09.2022, të cilat pasi janë korrigjur nga propozuesi janë miratuar nga Prefekti.

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve gjatë muajit janar-dhjetor 2022, këshilli ka mbajtur 24 mbledhje. 12 mbledhje të radhës, 12 mbledhje jashtë radhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare, në ato mbledhje të organizuara me mjete të komunikimit elektronik.

Për periudhën 12-mujore janë bërë 116 mbledhje të komisioneve të përhershëm, pjesa më e madhe e mbledhjeve me vendim të tyre janë mbajtur me mjete të komunikimit elektronik. Gjatë 12 mujorit janë dorëzuar 306 raporte të mbajtura nga komisionet e përhershëm.

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka dhe faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarë të ndryshëm.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Parim i një procesi të drejtë vendimmarrës është që: “Ai që ka përgjegjësinë për të vendosur duhet të dëgjojë”. Në zbatim dhe të këtij parimi del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Me kaq po e mbyll. Ju uroj punë të mbarë për vitin 2023 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Keni ndonjë sygjerim për përmirësimin e punës së Këshillit?

Nuk kemi.

- Kalojmë në **pikën 7** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Përshëndetje.

Komisioni i Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 7, propozon unanimitisht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 8** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Gjithashtu Komisioni pasi mori në shqyrtim pikën 8, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe komisioni jonë është dakort ta kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 9**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Gjithashtu dhe për pikën 9 pasi e morëm në shqyrtim propozojmë për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe komisioni jonë është pro.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 10**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Unanimisht propozojmë për pikën 10 për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe komisioni është dakort të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 10, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin të vënë në dispozicion nga stafi i bashkisë “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve, që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social” ra dakort unanimisht për ta kaluar sot në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 11, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Artion Beqiraj : Po, kam unë.

Ani Dyrmishi : Po, z. Beqiraj.

Artion Beqiraj : Interesohem për personat që kanë aplikuar më parë, para se të miratohet sistemi i pikëzimit, me cilin sistem do vlerësohen ? Pra, ato që kanë aplikuar tashmë me cilin sistem pikëzimi do të miratohen?

Diana Mandia (*specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Publike*) : Po, çdo vit nga këshillin bashkiak kriteret e sistemit të pikëzimit përcaktohen sipas ligjit 22 të 2018-ës dhe këtë sistem të pikëzimit i nxjerr në sistemin online tek e-albania, para se të fillojnë aplikimet për programet e strehimit. Një nga programet e strehimit siç dihen sipas ligjit 22, janë banesat sociale, bonuset e strehimit social, grantet e që na jep qeveria për përmirësimin e kushteve. Domethënë sistemin e pikëzimit e miratojmë në fillim pastaj aplikojnë programet e strehimit.

Etleva Budini : Kam një pyetje.
Do riaplikojnë më pas?

Diana Mandia : Jo aplikimi tashi fillon çdo fillim vitit, miratojmë sistemin dhe pas sitemit fillon aplikimi.

Etleva Budini : Pra fillon në bazë të sistemit të ri.

Diana Mandia: Po, sistemit të ri.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente të tjera ka?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 12**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe për këtë pikë komisioni ynë pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin të vënë në dispozicion nga stafi i bashkisë vendosi unanimisht për kalimin në votim “Për miratimin e komisionit të strehimit pranë bashkisë Durrës për vitin 2023”.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 12, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 12 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 13**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni i Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 13 propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe komisioni ynë unanimitisht votoi për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

Fatmir Mërkuri : Edhe komisioni ynë vendosi unanimitisht për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 13, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 13 e rendit ditës dhe e fundit për sot.

Duke qënë se asnjë këshilltar nuk e ka kërkuar fjalën, mbledhjen e deklaroj të mbyllur . Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria e Këshillit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 11 (njëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ (mungon)

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Përfaqësues i Grupit të Pavarur të KB :

FLUTURA KASA